UDHËZIM
Nr. 24, datë 11.9.2025

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 25, DATË 1.12.2023, "PËR PILOTIMIN E SKEMËS SË MËSUESIT NË DISPOZICION DHE DETYRAVE TË TIJ NË INSTITUCIONET ARSIMORE PUBLIKE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës; të pikës 6, të nenit 57, e të nenit 26, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe të urdhrit nr. 609, datë 20.12.2024, të ministrit të Arsimit dhe Sportit, "Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit, znj. Orjana Osmani",

UDHËZOJ**:**

1. Në pikën 1, të kreut I, të udhëzimit nr. 25, datë 1.12.2023, "Për pilotimin e skemës së mësuesit në dispozicion dhe detyrave të tij në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar", i ndryshuar, togfjalëshi "... *për vitin shkollor 2024–2025*", zëvendësohet me togfjalëshin "... *për vitin shkollor 2025–2026*".

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi sekretari i përgjithshëm, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSMINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Orjana Osmani